



THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

për të ndjekur kursin një semestër për **“Drejtësia Tranzicionale: Roli i Universitetit në adresimin e çështjeve të së kaluarës”** – për të gjithë të interesuarit

Përmes këtij njoftimi, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” – Fakulteti Juridik, Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë dhe Community Building Mitrovica (CBM) i fton të gjithë studentët që të aplikojnë për pjesëmarrje në kursin “Drejtësia Tranzicionale: Roli i Universitetit në adresimin e çështjeve të së kaluarës”, i cili do të zgjasë një semestër.

Qëllimi i këtij kursi është ndërtimi i kompetencave të pjesëmarrësve me anë të një programi që do të mundësojë edukimin për proceset e drejtësisë tranzicionale, si një nga mënyrat për të kontribuar drejt ndërtimit të paqes të bazuar në vlerat e të drejtave të njeriut, mirëkuptimit kulturor, dhe komunitetit si një faktor kyç për ndërtimin e paqes. Me njohuritë e marrura nga ky kurs, pjesëmarrësit në të ardhmen do të mund të jenë promotorë të vlerave të lartpërmendura në vendet e punës dhe karrierës së tyre profesionale.

Rezultati i pritur është që pjesëmarrësit në këtë kurs:

- Do të fitojnë njohuri më të thella në të kuptuarit dhe argumentimin e drejtësisë tranzicionale, të drejtave të njeriut, dhe procesit të ndërtimit të paqes;
- Do të jenë në gjendje të punojnë në përmirësimin e të kuptuarit të konceptit të drejtësisë tranzicionale dhe respektimin e të drejtave të njeriut me theks të veçantë çështjet e tematikës së Republikës së Kosovës;
- Do të fitojnë njohuri dhe aftësi që të marrin pjesë aktivisht dhe pozitivisht në çështjet e drejtësisë tranzicionale, të drejtave të njeriut dhe procesin e ndërtimit të paqes;
- Do të fitojnë njohuri më të thella mbi rastet e ndryshme të shteteve që kanë kaluar në procesin e drejtësisë tranzicionale, në nivel rajonal dhe atë ndërkombëtar;
- Do të jenë kompetentë për t'i transferuar njohuritë dhe shkathtësitë e fituara në ambientet e tyre personale dhe profesionale.

Të gjithë pjesëmarrësit, të cilët do t'i përmbushin detyrimet e tyre nga ky kurs, do t'u jepet Çertifikata e Pjesëmarrjes, lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Norvegjisë.

Numri i pjesëmarrësve është i kufizuar. Në këtë kurs do të marrin pjesë 25-30 pjesëmarrës, të zgjedhur në bazë të dëshmive të paraqitura nga aplikantët, ku kujdes i veçantë do të tregohet për pranimin e pjesëmarrësve me përfaqësim proporcional të të dy gjinive, si dhe të pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike dhe fetare.

Ky aktivitet është inicuar dhe është duke u implementuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Juridik. Projekti është financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë. CBM është OJQ partnere në Kosovë në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

Kursi do të zhvillohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

Afati i fundit për aplikim: E Premte, 10 Shkurt 2017

Ky kurs është pa pagesë.

Ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe një letër motivimi në e-mail adresën: drejttesiartranzicionale@uni-pr.edu, me titull “Drejtësia Tranzicionale: Roli i Universitetit në diskutimin e çështjeve të së kaluarës”

Të përzgjedhurit, do të informohen përmes emailit më **13 Shkurt 2017**.